

NDËRLIDHJA E KOMUNIKIMIT TË MËSIMDHËNËSVE ME PERFORMANCËN DHE  
MOTIVIMIN AKADEMIK TË NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME NË KOSOVË

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

AGNESA MIRDITA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË  
PRISHTINË

PRILL, 2022

NDËRLIDHJA E KOMUNIKIMIT TË MËSIMDHËNËSVE ME PERFORMANCËN DHE  
MOTIVIMIN AKADEMIK TË NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME NË KOSOVË

NGA

AGNESA MIRDITA

Mentore: Prof. Ass. Dr. Liridona Jemini-Gashi

Komunikimi i mësimdhënësve konceptualizohet si pjesë e sferës së përcaktimit të efektivitetit të mësimdhënësit, dhe është një element vital në krijimin e një mjedisi që motivon nxënësit në të mësuar. Nisur nga kjo, një komunikim i mirëfilltë mes tyre është ai që luan rol kyq në krijimin e një mjedisi kualitativ mësimor. Me anë të tij nxënësit arrijnë të perceptojnë klasën si më përmbajtësore, dhe kjo ndikon që ata të jenë më shumë të interesuar në arritjet akademike, ndihen më të ditur dhe të motivuar. Mësimdhënësit poashtu mund të arrijnë të zgjojnë edhe interesimin emocional, që i bënë nxënësit të ndihen më të përfshirë në klasë dhe mësim si dhe rrit dëshirën për sukses akademik. Edukimi i suksesshëm është qështje preokupuese jo vetëm në nivel lokal por edhe atë vendor. Arritjet akademike janë ndër parashikuesit më të fortë të të ardhurave në të ardhmen dhe mundësive të jetësore. Prandaj, vendet në mbarë botën përpiqen të përmirësojnë sektorin e tyre arsimor në mënyrë që të rrisin aftësitë e të rinjve të tyre dhe të krijojnë një fuqi punëtore kompetente që do të kontribuojë në mënyrë të parashikueshme në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Nisur nga vendet tjera në botë të cilat i kushtojnë rëndësi jashtëmase studimit të komunikimit të mësimdhënësve si një faktor unik në jetën e nxënësve, vjen edhe ky studim në kontekstin Kosovar. Ky studim kishte për qëllim të hulumtojë sjelljen e perceptuar të komunikimit të mësimdhënësve në disa dimensione si sfidimi në klasë, inkurajimi dhe lavdatat verbale, përkrahja joverbale, sjelljet e të qenurit kuptues dhe kontrollues ndaj nxënësve. Për më

teper do te shohim edhe ndërlidhjen qe ka komunikimi edhe me dy variabla te tjera, qe jane performanca akademike dhe motivimi akademik i nxenesve. Si dhe te shohë ndikimin qe kanë variablat tek njera tjetra dhe dallimet gjinore mes tyre. Përkatesisht, me ane te ketij studimi synohet te marrim pergjigjie per pyetjet kerkimore 1) A ka dallime signifikante ne sjelljen e perceptuar te komunikimit te mesimdhenesve dhe performancës akademike ne mes te lendës së gjuhës angleze dhe matematikes? 2) A ka ndërlidhje signifikante ne mes te sjelljes së perceptuar te mesimdhenesve me motivimin dhe performancen akademike? 3) cili është ndikimi i sjelljes së perceptuar e komunikimit te mesimdhenesve ne performancën akademike te nxenesve dhe motivimin akademik?; 4) Si ndikon motivimi ne performancën akademike? Dhe 5) Cilat jane dallimet gjinore ne perceptimet e nxenesve per sjelljen e perceptuar te komunikimit te mesimdhenesve, ne performancën, dhe motivimin akademik?

Ne kete hulumtim moren pjesë ne total 341 nxenes nga katër shkolla te mesme te Kosovës, dy nga komuna e Prizrenit dhe dy nga komuna e Pejës. Nga nxenesit qe plotësuan pyetesoret, 194 ose 56.9% ishin te gjinisë femërore, ndërsa 147 ose 43.1% te gjinisë mashkullore. Nxenesit pjesëmarrës ishin nga tri klasa te ndryshme, ku 41.6% prej tyre ishin pjesë e klasës së 10-të, ndërsa ne klasën e 11-të ishin 24.0% , dhe ne klasën e 12-të ishin 34.3%. Per te matur sjelljen e perceptuar te komunikimit te mesimdhenesve dhe performancës akademike jane bërë vlerësimet per mesimdhenes te dy lendëve shkollore: gjuhë angleze dhe matematikë. Ku jane vërejtur dallime signifikante si ne perceptimin qe nxenesit kanë per sjelljen e komunikimit te mesimdhenesve ashtu edhe ne performancë akademike. Rezultatet poashtu treguan per ndërlidhje signifikante ne mes te variablave, ndonëse nga performanca akademike ndërlidhje më te lartë me sjelljen e perceptuar te mesimdhenesve kishte tek lënda e matematikës. Tutje, është gjetur qe sjellja e perceptuar e komunikimit te mesimdhenesve ka pjesërisht ndikim tek

motivimi, ndërsa përformanca akademike ndikon shumë në atë se sa i motivuar është një nxënës. Ndërsa, në anën tjetër përformanca akademike ndikohet nga niveli i motivimit akademik të nxënësit, por jo edhe nga sjellja e përceptuar e komunikimit të mësimitdhënësit. Sa i përket dallimeve gjinore kemi të dhëna signifikante të cilat tregojnë që vajzat në tërësi e përceptojnë si më pozitive sjelljen e përceptuar të komunikimit të mësimitdhënësve, si rrjedhojë janë edhe më të motivuara dhe tregojnë përformancë më të lartë akademike në të dy lëndët.

Të dhënat e dala janë shumica relevante me hipotezat e ngritura dhe me studimet e kryera në vende të tjera. Është e rëndësishme të merren për bazë rezultatet dhe të punohet më shumë në profesionin e mësuesit\es dhe në profesionin e mësimitdhënies. Çfarë ndodhë në klasë nuk mbetet asnjëherë vetëm aty, por afekton jetën e nxënësve edhe jashtë mureve të shkolles. Shkolla është një institucion ku fëmijët kalojnë një pjesë shumë të madhe të fëmijërisë dhe rinisë së tyre. Si rrjedhojë edhe figura e mësimitdhënësit ka një rol të padiskutueshëm në shumë aspekte të jetës së nxënësve. Qasja e tyre ndaj nxënësve e bënë shkollën një vend më të përshtatshëm për ta, ku përpos të nxënësve ata arrijnë t'a përceptojnë atë si një vend më të sigurtë dhe të dashur. Kjo qasje realizohet me anë të komunikimit që mësimitdhënësit përdorin, i cili mund të ndikojë pozitivisht ose negativisht në perceptimet e tyre. Shumë studime të paraqitura më lart e përshkruajnë rolin kyq të komunikimit të mësimitdhënësve në sigurimin e një klime pozitive në klasë e cila nxitë motivimin për të mësuar dhe si rrjedhojë rritet edhe përformanca akademike. Prandaj trajnimi profesional i mësimitdhënësve me fokus komunikimin e tyre me nxënësit do të ndihmonte shumë në vetëdijësimin e tyre për impaktin që ka çdo sjellje e tyre tek motivimi i nxënësve. Kjo do të mund të ndikonte që ata të përkushtohen në sjellje kuptimplote të cilat i komunikojnë nxënësit që është i vlerësuar dhe i rëndësishëm për klasen. Qasje të tilla do rrisnin dëshirën për të qenë më të

sukseshëm në shkollë dhe do të ishin më të motivuar për të arritur performancë sa më të lartë akademike.